



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 12, paragrafët 1 dhe 2, shkronja (c), të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), të nenit 40 dhe 61 të Ligjit nr. 2004/18 për tregtinë e brendshme, nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-005, për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 2004/18, për tregtinë e brendshme, si dhe të nenit 52, shkronja (h) dhe nenit 33 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, me propozim të Drejtorisë së Shëndetësisë, Kuvendi i Kryeqytetit, më 04.09.2023, miratoi këtë

**RREGULLORE**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR FILLIMIN DHE**  
**MBARIMIN E ORARIT TË PUNËS SË ORGANIZATAVE TË BIZNESIT NË KOMUNËN E**  
**PRISHTINËS, NR. 110-1203, DT. 16.06.2010**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

Me këtë Rregullore bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të organizatave të biznesit në komunën e Prishtinës, nr. 01. nr. 110-1203, të datës 16.06.2010.

**Neni 2**  
**Ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores, 01. nr. 110-1203, të datës 16.6.2010.**

Neni 15 i Rregullores bazike ndryshohet dhe plotësohet si në vijim:

15.1. Orari i punës në ordinanca dhe klinika private do të jetë i njëjtë në dy sezonet, fillon në orën 7:00 dhe mbaron në orën 22:00.

15.2. Orari i punës për barnatore do të jetë i njëjtë në dy sezonet, fillon në ora 7: 00 dhe mbaron në orën 21:00.

15. 3. Orari i kujdestarisë për barnatore, të dielave dhe gjatë festave zyrtare është nga ora 7:00 deri në orën 07:00, kujdestarojnë 10 ( dhjetë) barnatore në gjithë Kryeqytetin.

15.4. Orari i kujdestarisë së natës për barnatore është nga ora 21:00 deri në orën 7:00, kujdestarojnë 5 (pesë) barnatore në gjithë Kryeqytetin. Orari i kujdestarisë duhet të publikohet nga barnaret dhe institucionet e kujdesit parësorë shëndetësorë.

15.5. Orari i kujdestarisë do të përgatitet nga barnaret e Kryeqytetit, në bashkëpunim me njëra-tjetrën, për periudhë njëvjeçare nga dita e miratimit të kësaj Rregulloreje, i cili orar do të ripërtërihet çdo vit, dhe do të sjellët për miratim në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe në Drejtorinë e Shërbimeve Publike - Sektori për zhvillim të qëndrueshëm.

15.6. Gjobitet me gjobë prej 300 (treqind) deri në 1.000 (një mijë) Euro personi fizik dhe nga 1.000 (një mijë) deri 3.000 (tre mijë) Euro personi juridik, nëse nuk i përmbahet orarit të përcaktuar në paragrafin 15.2, 15.3 dhe 15.4.

### **Neni 3 Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-332/06-183645/23, më 05.09.2023

**KRYESUESI I KUVENDIT**

Pëllumb Bajçinovci

